



**Republika e Kosovës
Komunës e Malishevës
Drejtoria për Arsim dhe Edukim**



ë bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 17, pika h të Ligjit nr. 03/L – 040, për
përqendrimin lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të
nenit 34, paragrafi 34.1, pika (____) të Statutit të Komunës së Malishevës, Kuvendi i
Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur më: ____/____/____. miratoi këtë

DRAFT – RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Le këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret, kohëzgjatja e realizimit të bursës, lartësia e
bursës dhe procedura për ndarjen e bursave për studentë/e të Komunës së Malishevës, të cilët
studiojnë në universitete publike të Republikës së Kosovës.

Neni 2.

Komuna e Malishevës, varësisht nga mjetet financiare që ka në dispozicion, ndan bursa për
studentë/e të Komunës së Malishevës.

Neni 3.

Të gjithë studentët/et e rregullt, banorë të përhershëm të Komunës së Malishevës, pa
irrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultetë
në universitete publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime
postuniversitare – master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të
studimeve.

Neni 4.

Kryetari i Komunës merr vendim për numrin e bursave, që do të ndahen sipas fushave të studimeve, shumën financiare për një bursë, e që ndahet për një vit akademik - shkollor.

Neni 5.

1. Bursat për studentë/e do të ndahen nga Komisioni, i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.
2. Komisioni do të jetë i përbërë nga 3 anëtarë.

Neni 6.

1. Drejtoria e Arsimit do të shpallë konkursin për ndarjen e bursave. Konkursi duhet të jetë i shpallur në mjetet e informimit, përkatësisht në dy gazeta ditore, në ueb-faqen e Komunës, në tabelën e shpalljeve, dhe do të qëndrojë i shpallur për 15 ditë.
2. Në konkurs do të përcaktohet dokumentacioni i kërkuar dhe informatat tjera të nevojshme.

Neni 7.

1. Drejtoria e Arsimit obligohet që t'i kryejë punët e domosdoshme tekniko-administrative, që rrjedhin nga natyra e punës së Komisionit, si dhe punët rreth shpalljes së konkursit.
2. Pranimi i kërkesave do të bëhet në zyrën e pritjes për qytetarë;
3. Formulimi dhe nënshkrimi i kontratave do të bëhet në zyrën e Kryetarit të komunës.

II. KUSHTET DHE KRITERET

Neni 8.

1. Për realizimin e së drejtës në bursë, kandidatët /et duhet t'i plotësojnë kushte si në vijim:
 - 1) të kenë të regjistruar vitin akademik për të cilin jepet bursa;
 - 2) të mos jenë shfrytëzues/e të ndonjë burse tjetër ose të jenë të punësuar;
 - 3) kandidatët/et që janë regjistruar për herë të parë në fakultete, duhet të kenë dëshminë e suksesit të shkollës së mesme dhe diplomën paraprake;
 - 4) të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomiko-sociale të familjes.
2. Gjendja ekonomiko-financiare e familjes së kandidatit/es vërtetohet në bazë të dëshmive të lëshuara nga Qendra për Punë Sociale në Malishevë. Komisioni ruan të drejtën të hulumtojë dhe vërtetojë gjendjen reale ekonomiko-financiare të kandidatit/es.

III. KRITERET DHE PËRPARËSITË

Neni 9.

Për suksesin e arritur në mësim në vitin paraprak, dhe kriteret e tjera që vlerësohen kandidati/ja vlerësohet me pikë si në vijim:

- 1) Fëmijëve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së iu ndahet bursa duke marrë për bazë gjendjen socio ekonomike;
- 2) Përveç pikëve nga paragrafi paraprak, studentëve që u takojnë kategorive të veçanta u shtohen pikë si në vijim:
- 3) Fëmijës së invalidit të luftës i shtohen 20 pikë, kurse të veteranit të luftës i shtohen 15 pikë.
- 4) Fëmijës së martirit të luftës, studenti me gjendje të rëndë sociale, fëmija që është në mbikëqyrje të nënës, studentit që është me aftësi të kufizuara dhe studentit në familjen bërthamë ka dy e më tepër student i shtohen 10 pikë,
- 5) Fëmijëve pa prind u shtohen 20 pikë,
- 6) Studenti që ka marrë diploma, mirënjohje, certifikata kombëtare ose ndërkombëtare në ndonjë garë-konkurs në lëmin arsimor i shtohen 5 pikë

IV. KONKURSI

Neni 10.

konkursi duhet të përmbajë:

- a) kushtet për konkurrim.
- b) shumën e bursës për një vit kalendarik.
- c) dokumentet e nevojshme për konkurrim.
- d) profilet prioritare.
- e) afati për aplikim është 15 ditë kalendarike.

Neni 11.

Lari që bënë pranimin e aplikacioneve duhet:

- a) të kontrolloj dokumentet e aplikimit nëse janë apo nuk janë të kompletuara,
- b) të regjistroj dokumentet që i bashkëngjiten aplikacionit,
- c) të vërtetoj a është fotokopja e indeksit identike me origjinalin.

Neni 12.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- 1) certifikata e provimeve të dhëna së bashku me fotokopjen e indeksit.
- 2) deklarata e bashkësisë familjare.
- 3) dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale.
- 4) certifikatën e vendbanimit,

- e) diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor.
- f) Studentët që janë invalid të luftës, anëtar të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirit të luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuar duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse.

V. VLERËSIMI I KUSHTEVE DHE KRITEREVE

Neni 13.

Pas skadimit të afatit të konkurrimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e kërkesave. Gjatë procedurës së vlerësimit të kërkesave, komisioni do të përcaktojë metodën e punës dhe mënyrën e seleksionimit të kërkesave, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 14.

1. Pas përfundimit të procedurës së seleksionimit, komisioni do të hartojë listën e përgjithshme të kandidatëve/eve përfitues/e të bursës.
2. Lista e përfituesve do të shpallet publikisht dhe do të vendoset në tabelën e shpalljeve të Drejtorisë së Arsimit dhe në ëebfaqen e komunës së Malishevës.

Neni 15.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim:

- a) Çertifikata e provimeve të dhëna së bashku me fotokopjen e indeksit;
- b) Deklarata e bashkësisë familjare;
- c) Dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale;
- d) Çertifikatën e vendbanimit,
- e) Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor.
- f) Studentët që janë invalid të luftës, anëtar të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirit të luftës, me gjendje të rëndë sociale, student me aftësi të kufizuar duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse.

Neni 16.

Kundër vendimit për shpalljen e listës së përfituesve të bursave nga Komisioni për ndarjen e ursave, lejohet ankesa, e cila i drejtohet Komisionit të ankesave, i formuar "ad hoc" me

vendim të Kryetarit të Komunës. Ankesa ushtrohet në afat prej 7 ditëve nga dita e shpalljes së listës së përfituesve të bursave nga ana e komisionit.

2. Komisioni për shqyrtimin e ankesave, në afat prej 15 ditësh duhet të vendosë lidhur me ankesën e ushtruar.

Neni 17.

1. Me përfituesit/et e bursave do të lidhet kontrata, e cila do të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi/ja i bursës.

2. Nëse nuk nënshkruhet kontrata nga ana e studentit/es brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e njoftimit të kandidatit/es përfitues/e të bursës, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga bursa dhe përfitues do të jetë kandidati që është në listë sipas radhës.

3. Kohëzgjatja për dhënien e bursës, obligimet e përfituesit/es të bursës dhe kushtet tjera, do të përcaktohen me kontratë.

V. PROCEDURA E PAGESËS

Neni 18.

1. Mjetet financiare do të alokohen me 1 (një) ose 2 (dy) periudha të caktuara gjatë vitit fiskal në xhirollogaritë bankare të përfituesve, në bankën të cilën studenti/ja e ka përzgjedhur.

2. Drejtoria për Arsimit dhe Edukim në koordinim me Drejtorinë për Ekonomik dhe Financa, janë të obliguara të kujdesen për alokimin dhe zotimin e mjeteve të cekura më lart, në afatin kohor.

VI. DISPOZIATA SHFUQIZUESE DHE TË HYRJES NË FUQI

Neni 19.

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë akti i Komunës, që ka rregulluar kushtet dhe kriteret për ndarjen e bursave.

Neni 20.

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 21.

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të saj në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen e Komunës së Malishevës.

KRYESUESI I KUVENDIT